



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna Klinë

Zyra e Kryetarit të Komunës

01 Nr. 052-30675/26

Datë 22.09.2026

RAPORTI NGA PROCESI I ORGANIZIMIT TË DËGJIMEVE BUXHETORE PËR BUXHETIN KOMUNAL 2027-2029

Shtator, 2026

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	3
KALENDARI I NDËGJIMEVE BUXHETORE.....	4
SHPENZIMET KOMUNALE DHE PARASHIKIMI I TYRE 2027-2029.....	6
PROJEKTET ME PRIORITET,PLANIFIKIMI PËR VITET 2027-2029.....	8
GRUPI PUNUES.....	16
ECURIA E DËGJIMEVE BUXHETORE 2027-2029.....	17
TABELA E DETAJUAR E METODOLOGJISË SË DËGJIMEVE.....	19
VLERËSIMI I GRUPIT PUNUSE MBI KËRKESAT E QYTËTARVE.....	22

HYRJE

Draft Plani i Buxhetit paraqet një përmbledhje të planifikuar të shpenzimeve dhe të hyrave buxhetore për komunën e Klinës për periudhën afatmesme 2027-2029 si dhe shpërndarjen e resurseve financiare nëpër programe komunale sipas prioriteteve të qeverisë komunale të nxjerra nga dokumentet strategjike komunale dhe vendimet e Kuvendit komunal të Klinës.

Draft Plani i Buxhetit që po prezantojmë është një dokument i cili përgatitet nga administrata komunale dhe miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal.

Draft Plani i Buxhetit bazohet në parashikimet e mundshme reale të hyrave të planifikuara për periudhën afatmesme buxhetore: garantëve qeveritare në formë të kufijve buxhetor, parashikimet mbi trendin e të hyrave vetanake si dhe parashikimeve mbi donacionet e mundshme qoftë edhe në formë participimeve të qytetarëve (grave dhe burrave), si dhe parashikimet reale të shpenzimeve buxhetore nëpër programet komunale që janë në fushën e përgjegjësisë së tyre.

Hartimi i Planit të Buxhetit përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale, kërkuar me Qarkoren Buxhetore Komunale 2027/02 të lëshuara nga Ministria e Financave, punës dhe transferëve në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP). Qarkorja e buxhetit 2027-02 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti vjetor për vitin 2027-2029.

Bazuar në ligjin për Qeverisje Lokale, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Klinës, Nr. 01-110-1232/2010, të datës 07.04.2010, si dhe Udhëzimin Administrativ për Administratë (MAPL) Nr. 04/2023 të Hapur në Komuna, komuna e Klinës ka organizuar dëgjimet buxhetore; <https://kline.rks-gov.net/konsultimet-publike/>.

KALENDARI I NDËGJIMEVE BUXHETORE

Nr.	Planifikimi i dëgjimeve buxhetore	Vendi i mbajtjes së dëgjimit buxhetor	Data/dita e mbajtjes së dëgjimit	Koha/ora
1.	TAKIMI I - Salla e Konferencave, në Komunën e Klinës, me Kryetarët e Këshillave të Fshatrave.	Komuna Klinë, Salla e Konferencave.	27.08.2026	10:00
2.	TAKIMI II - SHFMU “Isa Boletini”, në fshatin Drenoc më banorët e fshatrave, Poterç i Epërm, Poterç i Poshtëm, dhe Dugajevë.	SHFMU “Isa Boletini”, në fshatin Poterç i Epërm.	28.08.2026	17:00
3.	TAKIMI III - SHFMU “Azem Bejta”, në fshatin Grabanicë, më banorët e fshatrave Grabanicë, Dollovë, Bokshiq, Këpuz dhe Qeskovë.	SHFMU “Azem Bejta”, në fshatin Grabanicë.	28.08.2026	18:00
4.	TAKIMI IV - SHFMU “Motrat Qiriazit”, në fshatin Zajm, më banorët e fshatrave Zajm, Gremnik, Deiq, Dolle, Jagodë dhe Dresnik.	SHFMU “Motrat Qiriazit”, në fshatin Zajm.	31.08.2026	17:00
5.	TAKIMI V - SHFMU “Avni Zhabota”, në fshatin Shtupel, më banorët e fshatrave Shtupel, Kërrnicë, Binxhë, Grabc, (komunitetin joshumicë).	SHFMU “Avni Zhabota”, në fshatin Shtupel.	31.08.2026	18:00
6.	TAKIMI VI - SHFMU “Ali Krasniqi”, në fshatin Ujmirë, me banorët e fshatrave, Ujmirë Jashanicë, Pogragjë, Dush i Vogël, Shtaric, Dush, Resnik, Siqevë Jelloc, Gjurgjevik i Madh, Qabiq Doberdol.	SHFMU “Ali Krasniqi”, në fshatin Ujmirë.	01.09.2026	17:00
7.	TAKIMI VII – SHFMU “Emin Duraku”, në fshatin Sferkë, me banorët e fshatrave, Sferkë, Gllarevë, Caravik, Volljakë, Qupevë Zabergjë, Përçevë, Rixhevë, Stapanic.	SHFMU “Ali Krasniqi”, në fshatin Sferkë.	01.09.2026	18:00
8.	TAKIMI VIII - SHFMU “Nënë Tereza”, në fshatin, Budisalc më banorët e fshatrave, Budisalc,	SHFMU “Nënë Tereza”, në fshatin Budisalc.	03.09.2026	17:00

	Zllakuqan, Berkovë, Ranoc, Leskoc, Nagllavë, Dranashiq, Stupë, Rudicë, Radulloc, Videjë, Krushevë e Madhe, Krushevë e Vogël dhe Rudicë.			
9.	TAKIMI IX – Salla e Konferencave”, me temë “Prioritetet e grave dhe të rinjve të komunës së Klinës.	Salla e Konferencave Komuna Klinë	03.09.2026	16:00
10.	TAKIMI X - Salla e Kuvendit Komunal Klinë, takim i përgjithshëm me banorët e Komunës së Klinës, qytetit dhe lagjeve, klinafcit dhe Gjurgjevik i Vogel	Salla e Kuvendit Komunal Klinë, në Klinë.	04.09.2026	10:00
11.	TAKIMI XI - Salla e Kuvendit Komunal Klinë, më Asamblen Komunalë të Femijëve.	TAKIMI XI - Salla e Kuvendit Komunal Klinë,	04.09.2026	11:30

Linku i i publikimit të kalendarit në web faqen zyrtare; <https://kline.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/08>

Grupi punues ka mbledhur komentet në këto takime e mbajtura, ato të pranuar në formë fizike, si dhe në formë elektronike, sipas afateve. Vlerësimi i kërkesave të qytetarëve është bërë duke pasur parasysh ndikimin e kërkesës në Draft Plani i Buxhetit 2027-2029, ndikimin e kërkesës në komunitetin e gjerë dhe afërsisë së kërkesës me prioritetet e komunës për zonën. Grupi punues ka trajtuar edhe implikimet buxhetore të kërkesave dhe ndikimin e tyre në linjtë buxhetore.

Sipas standardeve të UA nr. 04/2023 grupi punues me shumicë votash ka vendosur sipas arsytimit që janë në këtë raport. Mbi kriteret e paracaktuara grupi punues ka vendosur të pranoj, refuzoj apo adresoj kërkesat që janë pranuar nga qytetarët gjatë dëgjimeve buxhetore. Sipas kritereve të paracaktuara kërkesat janë trajtuar si vijon:

Pranuar: Kërkesa të cilat grupi punues i ka vlerësuar nevojë për qytetarët dhe ka rekomanduar të futen në buxhetin e komunës,

Pranuar pjesërisht: kërkesa të cilat grupi punues ka vlerësuar se ka nevojë dhe mund të përmbushen pjesërisht nga buxheti i komunës,

Refuzuar: Kërkesa të cilat grupi punues ka vlerësuar se nuk mund të përmbushen nga buxheti i komunës dhe janë jashtë mandatit,

Adresuar: Kërkesa të cilat grupi punues ka vlerësuar se nuk mund të adresohen nëpërmjet buxhetit për shkak se kërkesat adresohen nga institucionet e tjera apo mekanizmat administrativ të komunës dhe institucioneve të tjera.

Raporti përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor dhe është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare. Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe WORD dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Të gjithë emrat dhe fotografitë e qytetarëve që janë përdorur gjatë hartimit të këtij raporti janë marrë me pëlqimin e tyre. Grupi punues ka vendosur që të redaktoj dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuar mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky raport në ditën e miratimit do të bëhet publik dhe i njëjti i është dorëzuar Kryetarit të Komunës dhe Asamblesë së Komunës së Klinës, si pikë e veçantë për shqyrtim, para miratimit të Buxhetit Komunal 2027-2029.

Në faqen e komunës në kuadër të këtij procesi janë publikuar; Plani i Brendshëm i Punës i Grupit Punues për Organizimin e Dëgjimeve Buxhetore, Kalendar i Dëgjimeve, Plani i Punës për Organizimin e Dëgjimeve Buxhetore, ftesat për pjesëmarrje, raportet e shkurta nga dëgjimet, procesverbalet nga dëgjimet dhe materialet e tjera provuese të cilat janë të listuar në fund të këtij dokumenti si anekse.

Sipas planit të punës komuna ka organizuar njëmbëdhjetë dëgjime buxhetore dhe njëmbëdhjetë me takimin e Kuvendit Komunal, në të cilat kanë marrë pjesë **147** qytetarë fizikisht nëpër dëgjime, prej të cilëve **17 Gra** dhe **130 Burra**.

Grupi punues ka listuar **58 kërkesa**, prej të cilave, **39 janë pranuar**, **5 janë refuzuar** dhe **14 janë adresuar**.

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike, si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo të refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 2-6 të këtij raporti.

Draft Plani i Buxhetit 2027-2029, pas përmbylljes së procesit të dëgjimeve buxhetore, është finalizuar dhe është proceduar, në Kuvendin e Komunës së Klinës.

SHPENZIMET KOMUNALE DHE PARASHIKIMI I TYRE 2027-2029

Sipas rekomandimeve të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të komunikuar përmes Qarkores Buxhetore komunale 2027-01, komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në Strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2027, duke përjashtuar kategorinë Paga dhe Mëditje. Si rezultat Komuna e Klinës prezanton këtë ndarje të shpenzimeve në mes të kategorive të lejuara buxhetore:

Shtojca nr 1. Korniza Buxhetore Komunale, në euro:

Përshkrimi		2026 (viti aktual)	2027 (planifikim)	2028 (vlerësimet)	2029 (vlerësimet)
1 TË HYRAT TOTALE KOMUNALE		16,338,898.00	16,845,517.00	17,346,234.00	18,262,104.00
1	Të hyrat vetanake	1,551,784.00	1,704,854.00	1,759,875.00	1,848,773.00
1	Grantet dhe transferet qeveritare	14,787,114.00	15,140,663.00	15,586,359.00	16,413,331.00
2 SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE		16,338,898.00	16,845,517.00	17,346,234.00	18,262,104.00
2.1	Shpenzimet rrjedhëse	12,337,100.00	12,952,134.00	13,173,603.00	13,434,210.00
	Pagat dhe meditet	9,567,100.00	10,182,134.00	10,233,044.50	10,284,210.00
	Mallrat dhe shërbim	1,600,000.00	1,600,000.00	1,720,558.50	1,850,000.00
	Shërbime komunale	370,000.00	370,000.00	400,000.00	450,000.00
	Subvencionet	800,000.00	800,000.00	820,000.00	850,000.00
2	Shpenzimet Kapitale	4,001,798.00	3,893,383.00	4,172,631.00	4,827,894.00

3.4.1 Pagat dhe Meditet – kjo kategori e shpenzimeve në periudhën afatmesme pritet të rritet me një mesatare prej 3.11%. Pjesëmarrja e kategorisë së pagave dhe mediteve në shpenzimet përgjithshme buxhetore komunale në vitin 2027 pritet të mbetet në nivel të përafërt rreth 60.44% e buxhetit. Buxheti për paga dhe medite për vitin 2027 pritet të arrijë shumën prej **10,182,134.00 euro** (buxheti për gra 4,887,424.32 euro ose 48% dhe buxheti për burra 5,294,709.68 euro ose 52%).

3.4.2 Mallrat dhe Shërbimet -kategoria e shpenzimeve për mallra dhe shërbime në periudhën 2027 do të jetë e njëjtë krahasuar me vitin 2026. Ndërsa për periudhën 2028-2029 pritet të kemi një rritje të lehtë. Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, në vitin 2027 pritet të jetë rreth 9.49%. Buxheti për mallra dhe shërbime për vitin 2026 pritet të arrijë shumën prej **1,600,000.00 euro** (buxheti për gra 768,000.00 euro ose 48% dhe buxheti për burra 832,000.00 euro ose 52%).

3.4.3 Shpenzimet komunale - kategoria e shpenzimeve komunale në periudhën 2027 do të jetë e njëjtë krahasuar me vitin 2026. Ndërsa për periudhën 2028-2029 pritet të kemi një rritje të lehtë. Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, në vitin 2027 pritet të jetë rreth 2.19 %. Buxheti për shpenzime komunale për vitin 2027 pritet të arrijë shumën

prej 370,000.00 euro (buxheti për gra 177,600.00 euro ose 48% dhe buxheti për burra 192,400.00 euro ose 52%).

3.4.4 Subvencionet – kjo kategori e shpenzimeve Subvencione dhe tansfere në periudhen 2027 do të jetë e njëjtë krahasuar me vitin 2026. Ndërsa për periudhën 2028-2029 pritet të kemi një rritje të lehtë. Pjesëmarrja e transfereve dhe subvencioneve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore në vitin 2027 pritet të jetë rreth 4.74% . Në vitin 2027 subvencionet do të shpenzohen për shëndetësi (ndihmë për shërimë bazuar në kërkesat e deponuara), kulturë, rini e sport , arsim-bursa për student, bujqësi) etj . Buxheti për subvencionime për vitin 2027 pritet të arrijë shumën prej **800,000.00 euro (buxheti për gra 408,840.00 euro ose 50.73% dhe buxheti për burra 394,160.00 euro ose 49.27%)**.

3.4.5 Investimet Kapitale - kjo kategori e shpenzimeve në periudhen 2027-2029 do të shënojë rritje mesatare prej rreth 10.55% . Në vitin 2027 pritet rritje prej 4.75% krahasuar me vitin 2026. Një pjesë e madhe e tyre planifikohet të financohet nga të hyrat vetanake të komunës. Rritje më e madhe e investimeve kapitale, nga buxheti i komunës do të bëhet në vitin 2028 dhe 2029. Pjesëmarrja e investimeve kapitale në totalin e shpenzimeve të komunës në vitin 2027 pritet të jetë rreth 23.11 %. Buxheti për investimet kapitale për vitin 2027 pritet të arrijë shumën prej **3,893,383.0 euro (buxheti për gra 1,975,113.19 euro ose 50.73% dhe buxheti për burra 1,918,269.81 euro ose 49.27%)**.

Si pjesë e dytë që është elaboruar më së shumti gjatë dëgjimeve më interes dhe kërkesë të qytetarëve ishin edhe Investimet Kapitale. Investimet Kapitale janë prezantuar në detaje, më poshtë paraqet një komponentë të rëndësishme të buxhetit të komunës e cila ndonëse nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, mbetet me rëndësi të posaçme në aspektin e planifikimit gjithëpërfshirës, për Komunën e Klinës. Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore, ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Në këtë kontekst përmirësimi i infrastrukturës do të pozicionojë ekonominë e Komunës së Klinës në një rrugë të rritjes më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike në periudhë afatgjatë.

PROJEKTET ME PRIORITET, PLANIFIKIMI PËR VITET 2027-2029

Projektet me prioritet për vitin 2027

Nr.	Emri i projektit	Totali	10	21
1	Rindërtimi i rrugëve të Qytetit të Klinës me segmente të tyre: S.Rexhepi, M.Daka, M.Haxhaj, L.Palucaj, H.Prishtina, I.Qemajli, F.Bojaj, B.Mustafa, Sh.Sadiku, HKrasniqi, Vellezerit Gervall	30,000.00	30,000.00	-
2	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Klinë, rrugën Martirët e Pastaselit, Martirët e Kralanit etj	20,000.00	20,000.00	-
3	Bashkëfinancim me donatorë	1,453,250.00	1,250,000.00	203,250.00
4	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Videjë – Polcë – Paskalicë – Jagodë – Krushevë e Madhe.	10,000.00	10,000.00	-
5	Ndërtimi i segmenteve të rrugës Malë Bashota, Dositej Obradović, Bekim Fehmiu, Shaban Sadiku, Heronjtë e Kombit dhe infrastrukturës nëntokësore në Klinë-Dersnik-Dolac	480,000.00	160,000.00	320,000.00
6	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore (Trotuare) dhe infrastrukturës nëntokësore në Zajm-Deiq	50,000.00	30,000.00	20,000.00
7	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore Poterq-Dugajevë-Drenovc	40,000.00	20,000.00	20,000.00

8	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore Zllakuqan-Pataqan-Berkove, Krushevë e Vogël (trotuari Klinë-Zllakuqan)	50,000.00	30,000.00	20,000.00
9	Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në Shtupel-Kërrnicë-Binxhe-Grac	10,000.00	10,000.00	-
10	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore Volljakë-Sferkë-Qupevë-Dush	50,000.00	30,000.00	20,000.00
11	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Cerovik-Qabiq-Dobërdol	30,000.00	20,000.00	10,000.00
12	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Ranoc-Leskoc	5,000.00	5,000.00	
13	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Sipeve-Ujmire-Shtarice	75,000.00	20,000.00	55,000.00
14	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe urës në Budisalcë-Rudicë	20,000.00	-	20,000.00
15	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Gllarevë – Rixhevë – Stapanicë – Zabërgjë	45,000.00	25,000.00	20,000.00
16	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Gjurgjevik të Vogël – Klinavc	15,000.00	15,000.00	
17	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Grabanicë-Bokshiq-Dollovë	20,000.00	20,000.00	-
18	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Gjurgjevik të Madh – Dush.	20,000.00	20,000.00	
19	Ndërtimi i shtratit të lumit Klina, (Klinë-Burimi i Jarinës - Pogragjë-Ujmirë), Rregullimi i shtratit të lumit Lumëbardhi i Pejës dhe lumit Drini i Bardhe	50,000.00	50,000.00	-
20	Ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe infrastrukturës rrugore në Grykën e Jarinës – Pogragjë	5,000.00		5,000.00
21	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Jashanicë-Jelloc-Resnik	40,000.00	40,000.00	
22	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Perqevë edhe rrugën "Shpella Azem Bejta - Përqevë"	150,000.00	100,000.00	50,000.00
23	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Gremnik-Qupevë e Ulët	10,000.00	-	10,000.00
24	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Qeskovë-Kepuz-Rastoka	10,000.00	-	10,000.00
25	Ndërtimi i rrugës "Bedri Mustafa" në Klinë	100,000.00	100,000.00	
26	Ndërtimi i rrugës "Shaban Sadiku" në Klinë	50,000.00		50,000.00
27	Ndërtimi i rrugës "Shaban Polluzha" në Dersnik	36,750.00	36,750.00	-
28	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Klinë, rrugën Haxhi Zeka, etj	20,000.00		20,000.00
29	Ndërtimi i Urës mbi Lumin Drini i Bardhë në Volljakë	5,000.00		5,000.00
30	Ndërtimi i nxemjes qendrore për Qytetin e Klinës	5,000.00		5,000.00
31	Ndërtimi i Nënkalimit në Lagjen e Dukagjinit - Klinë	0.00		-
	Urbanizmi	2,905,000.00	2,041,750.00	863,250.00
32	Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve) në Këpuz, Shtupel, Zllakuqan, Gremnik, Volljak etj	60,000.00	40,000.00	20,000.00
33	Ndërtimi i ujësjellësit në Drenovcë - Poterqi i Poshtëm - Dugujevë - Zajmë - Pataqan - Leskoc - Ranoc etj.	83,383.00	40,000.00	43,383.00

34	Zgjerimi i rrjetit te ndriqimit publik ne Dollc-Dresnik, Jashanice, Drenoc, Shtupel, Kline, Leskoc, Gremnik, Qupeve e ulet, Siqevë, Resnik, Gj. Madhe, Dush etj	80,000.00	50,000.00	30,000.00
35	Rindertimi i infrastruktures mbitokesore me asfalt ne Jashanice, Shtupel, Zllakuqan, Kline-Videje etj	170,000.00	120,000.00	50,000.00
36	Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujrave të zeza në Ranoc, Radulloc, Shtupel, Shtaricë etj	40,000.00	-	40,000.00
37	Ndërtimi i rrethojave të vorrezave në Gj. Madh, Volljak, Sferkë, Jashanice, Siqevë, Gremnik, Zajm, K. e Vogël, Shtupel, Grabanicë etj	90,000.00	60,000.00	30,000.00
	Infrastruktura rrugore	523,383.00	310,000.00	213,383.00
38	Furnizimi me tabela të mençura për shkollat në Çabiq, Ujmirë, “Ismet Rraci”, “Motrat Qiriazit”, “Fehmi Agani”, “Luigj Gurakuqi”, etj	20,000.00		20,000.00
39	Ndërtimi i nxemjeve qendrore me pompa termike dhe nxemje me kalda me pellet ne shkolla në Gjimnazin Luigj Gurakuqi, Gremnik, Këpuz, Zllakuqan, Gjurgjevik I Madh, Budisalc, Ujmirë, Drenoc etj	80,000.00	-	80,000.00
40	Ndriqimi i hapësirave të jashtme në shkollën Ismet Rraci, Motrat Qiriazit, Gjimnazin Luigj Gurakuqi, Zllakuqan, Çerdhja e fëmijëve etj	0.00		-
41	Ndërtimi i fushave sportive dhe parkingjeve në shkolla në Grabanicë, Siqevë, Zllakuqan, Leskoc, Sferkë etj	50,000.00	-	50,000.00
	Arsimi	150,000.00	-	150,000.00
42	Furnizim me pajisje mjekësore për diagnostikë për QKMF-Klinë	50,000.00		50,000.00
43	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve shëndetësore: QKMF-së, AMF-së në Drenoc, Ujmirë, Zllakuqan dhe Gllarevë, etj.	10,000.00		10,000.00
	Shëndetësia	60,000.00	-	60,000.00
44	Ndërtimi i shtëpise se pleqeve ne Kline	-	-	-
	Sherbimet Rezidenciale	-	-	-
45	Ndërtimi dhe rindërtimi i objektit komunal ne Kline	85,000.00	4,804.00	80,196.00
46	Blerja e veturave zyrtare për nevoja të Administratës Komunale	35,000.00	5,000.00	30,000.00
	Administrata	120,000.00	9,804.00	110,196.00
47	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve sportive dhe të kulturës në Klinë	25,000.00	-	25,000.00
	Kultura	25,000.00	-	25,000.00
48	Furnizim me pajisje- aparat për matje gjeodezike	0.00	-	-
	Gjeodezia	-	-	-
49	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në Rudicë-Stupë-Videjë- Zajm, Potërq-Dollovë, Volljakë-Këpuz etj	110,000.00	80,000.00	30,000.00
	Bujqesia	110,000.00	80,000.00	30,000.00
	Totali :	3,893,383.00	2,441,554.00	1,451,829.00

Projektet me prioritet për vitin 2028

Nr.	Emri i projektit	Totali	10	21
1	Rindërtimi i rrugëve të Qytetit të Klina me segmente të tyre: S.Rexhepi, M.Daka, M.Haxhaj, L.Palucaj, H.Prishtina, I.Qemajli, F.Bojaj, B.Mustafa, Sh.Sadiku, HKrasniqi, Vellezerit Gervall	20,000.00	20,000.00	-
2	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Klinë, rrugën Martirët e Pastaselit, Martirët e Kralanit etj	20,000.00	20,000.00	-
3	Bashkëfinancim me donatorë	1,670,000.00	1,000,000.00	670,000.00
4	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Videjë – Polcë – Paskalicë – Jagodë – Krushevë e Madhe.	22,631.00	22,631.00	-
5	Ndërtimi i segmenteve të rrugës Malë Bashota, Dositej Obradović, Bekim Fehmiu, Shaban Sadiku, Heronjtë e Kombit dhe infrastrukturës nëntokësore në Klinë-Dersnik-Dollc	250,000.00	250,000.00	-
6	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore (Trotuare) dhe infrastrukturës nëntokësore në Zajm-Deiq	55,000.00	45,000.00	10,000.00
7	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore Poterq-Dugajevë-Drenovc	60,000.00	30,000.00	30,000.00
8	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore Zllakuqan-Pataqan-Berkove, Krushevë e Vogël (trotuari Klinë-Zllakuqan)	50,000.00	40,000.00	10,000.00
9	Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në Shtupel-Kërrnicë-Binxhe-Grapc	20,000.00	20,000.00	-
10	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore Volljakë-Sferkë-Qupevë-Dush	80,000.00	50,000.00	30,000.00
11	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Cerovik-Qabiq-Dobërdol	50,000.00	50,000.00	
12	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Ranoc-Leskoc	20,000.00	10,000.00	10,000.00
13	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Siqevë-Ujmire-Shtarice	45,000.00	30,000.00	15,000.00
14	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe urës në Budisalcë-Rudicë	30,000.00	30,000.00	
15	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Gllarevë – Rixhevë – Stapanicë – Zabërgjë	50,000.00	40,000.00	10,000.00
16	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Gjurgjevik të Vogël – Klinavc	40,000.00	40,000.00	
17	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Grabanicë-Bokshiq-Dollovë	40,000.00	30,000.00	10,000.00
18	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Gjurgjevik të Madh – Dush.	30,000.00	20,000.00	10,000.00
19	Ndërtimi i shtratit të lumit Klina, (Klinë-Burimi i Jarinës - Pogragjë-Ujmire), Rregullimi i shtratit të lumit Lumëbardhi i Pejës dhe lumit Drini i Bardhe	50,000.00	30,000.00	20,000.00
20	Ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe infrastrukturës rrugore në Grykën e Jarinës – Pogragjë	10,000.00		10,000.00
21	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Jashanicë-Jelloç-Resnik	50,000.00	50,000.00	

22	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Perqevë edhe rrugën "Shpella Azem Bejta - Përqevë"	100,000.00	70,000.00	30,000.00
23	Ndërtimi i infrastruktures mbitokësore dhe nëntokësore në Gremnik-Qupevë e Ulët	40,000.00	30,000.00	10,000.00
24	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Qeskovë-Kepuz-Rastoka	30,000.00	30,000.00	-
25	Ndërtimi i rrugës "Bedri Mustafa" në Klinë	300,000.00	250,000.00	50,000.00
26	Ndërtimi i rrugës "Shaban Sadiku" në Klinë	50,000.00		50,000.00
27	Ndërtimi i rrugës "Shaban Polluzha" në Dersnik	100,000.00	50,000.00	50,000.00
28	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Klinë, rrugën Haxhi Zeka, etj	20,000.00		20,000.00
29	Ndërtimi i Urës mbi Lumin Drini i Bardhë në Volljakë	10,000.00	10,000.00	
30	Ndërtimi i nxemjes qendrore për Qytetin e Klinës	10,000.00		10,000.00
31	Ndërtimi i Nënkalimit në Lagjen e Dukagjinit - Klinë	10,000.00		10,000.00
	Urbanizmi	3,332,631.00	2,267,631.00	1,065,000.00
32	Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve) në Këpuz, Shtupel, Zllakuqan, Gremnik, Volljak etj	70,000.00	50,000.00	20,000.00
33	Ndërtimi i ujësjellësit në Drenovcë - Poterqi i Poshtëm - Dugujevë - Zajmë - Pataqan - Leskoc - Ranoc etj.	50,000.00		50,000.00
34	Zgjerimi i rrjetit të ndriqimit publik në Dollc-Dresnik, Jashanice, Drenovc, Shtupel, Kline, Leskoc, Gremnik, Qupeve e ulet, Siqevë, Resnik, Gj. Madhe, Dush etj	70,000.00	50,000.00	20,000.00
35	Rindërtimi i infrastruktures mbitokësore me asfalt në Jashanice, Shtupel, Zllakuqan, Kline-Videje etj	150,000.00	100,000.00	50,000.00
36	Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujrave të zeza në Ranoc, Radulloc, Shtupel, Shtaricë etj	40,000.00	-	40,000.00
37	Ndërtimi i rrethojave të vorrezave në Gj. Madh, Volljak, Sferkë, Jashanicë, Siqevë, Gremnik, Zajm, K. e Vogël, Shtupel, Grabanicë etj	80,000.00	80,000.00	-
	Infrastruktura rrugore	460,000.00	280,000.00	180,000.00
38	Furnizimi me tabela të mençura për shkollat në Çabiq, Ujmirë, "Ismet Rraci", "Motrat Qiriazzi", "Fehmi Agani", "Luigj Gurakuqi", etj	10,000.00		10,000.00
39	Ndërtimi i nxemjeve qendrore me pompa termike dhe nxemje me kaldaja me pelet në shkollën në Gjinnazin Luigj Gurakuqi, Gremnik, Këpuz, Zllakuqan, Gjurgjevik I Madh, Budisalc, Ujmirë, Dren	90,000.00		90,000.00
40	Ndriqimi i hapësirave të jashtme në shkollën Ismet Rraci, Motrat Qiriazzi, Gjinnazin Luigj Gurakuqi, Zllakuqan, Çerdhja e fëmijëve etj	-		-
41	Ndërtimi i fushave sportive dhe parkingjeve në shkollën në Grabanicë, Siqevë, Zllakuqan, Leskoc, Sferkë etj	50,000.00	30,000.00	20,000.00
	Arsimi	150,000.00	30,000.00	120,000.00

42	Furnizim me pajisje mjeksore per diagnostike per QKMF-Klinë	30,000.00	-	30,000.00
43	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve shëndetësore: QKMF-së, AMF-së në Drenoc, Ujmirë, Zllakuqan dhe Gllarevë, etj.	10,000.00		10,000.00
	Shendetësia	40,000.00	-	40,000.00
44	Ndërtimi i shtëpise se pleqeve ne Kline	-		
	Sherbimet Rezidenciale	-	-	-
45	Ndërtimi dhe rindërtimi i objektit komunal ne Kline	20,000.00		20,000.00
46	Blerja e veturave zyrtare për nevoja të Administrates Komunale	35,000.00		35,000.00
	Administrata	55,000.00	-	55,000.00
47	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve sportive dhe të kulturës në Klinë	25,000.00	25,000.00	
	Kultura	25,000.00	25,000.00	-
48	Furnizim me pajisje- aparat për matje gjeodezike	-		
	Gjeodezia	-	-	-
49	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në Rudicë-Stupë-Videjë-Zajm,Potërqi-Dollovë, Volljakë-Këpuz etj	110,000.00	50,000.00	60,000.00
	Bujqesia	110,000.00	50,000.00	60,000.00
	Totali :	4,172,631.00	2,652,631.00	1,520,000.00

Projektet me prioritet për vitin 2029

Nr.	Emri i projektit	Totali	10	21
1	Rindërtimi i rrugëve te Qytetit te Klines me segmente te tyre: S.Rexhepi, M.Daka, M.Haxhaj, L.Palucaj, H.Prishtina, I.Qemajli, F.Bojaj, B.Mustafa, Sh.Sadiku,HKrasniqi,Vellezerit Gervall	30,000.00	30,000.00	-
2	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Klinë, rrugën Martirët e Pastaselit, Martirët e Kralanit etj	30,000.00	30,000.00	-
3	Bashkëfinancim me donatorë	1,660,000.00	1,100,000.00	560,000.00
4	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore në Videjë – Polcë – Paskalicë – Jagodë – Krushevë e Madhe.	40,000.00	40,000.00	-
5	Ndërtimi i segmenteve të rrugës Malë Bashota, Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu, Shaban Sadiku, Heronjtë e Kombit dhe infrastrukturës nëntokësore në Klinë-Dersnik-Dollc	657,894.00	478,000.00	179,894.00
6	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore(Trotuare) dhe infrastruktutes nentokesore ne Zajm-Deiq	100,000.00	70,000.00	30,000.00
7	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore Poterqi-Dugajevë-Drenovc	60,000.00	40,000.00	20,000.00
8	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore Zllakuqan-Pataqan-Berkove, Krushevë e Vogël (trotuari Klinë-Zllakuqan)	70,000.00	50,000.00	20,000.00
9	Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në Shtupel-Kërrnicë-Binxhe-Grapc	20,000.00	20,000.00	-

10	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore Volljakë-Sferkë-Qupevë-Dush	65,000.00	50,000.00	15,000.00
11	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Cerovik-Qabiq-Dobërdol	40,000.00	30,000.00	10,000.00
12	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Ranoc-Leskoc	30,000.00	20,000.00	10,000.00
13	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Sipeve-Ujmire-Shtarice	80,000.00	50,000.00	30,000.00
14	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe urës në Budisalcë-Rudicë	40,000.00	30,000.00	10,000.00
15	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Gllarevë – Rixhevë – Stapanicë – Zabërgjë	55,000.00	35,000.00	20,000.00
16	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Gjurgjevik të Vogël – Klinavc	60,000.00	50,000.00	10,000.00
17	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Grabanicë-Bokshiq-Dollovë	50,000.00	30,000.00	20,000.00
18	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Gjurgjevik të Madh – Dush.	30,000.00	30,000.00	
19	Ndërtimi i shtratit të lumit Klina, (Klinë-Burimi i Jarinës - Pogragjë-Ujmirë), Rregullimi i shtratit të lumit Lumëbardhi i Pejës dhe lumit Drini i Bardhe	100,000.00	80,000.00	20,000.00
20	Ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe infrastrukturës rrugore në Grykën e Jarinës – Pogragjë	10,000.00		10,000.00
21	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Jashanicë-Jelloc-Resnik	50,000.00	30,000.00	20,000.00
22	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Perqevë edhe rrugën "Shpella Azem Bejta - Përqevë"	50,000.00	30,000.00	20,000.00
23	Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Gremnik-Qupevë e Ulët	40,000.00	30,000.00	10,000.00
24	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Qeskovë-Kepuz-Rastoka	30,000.00	30,000.00	
25	Ndërtimi i rrugës "Bedri Mustafa" në Klinë	70,000.00	50,000.00	20,000.00
26	Ndërtimi i rrugës "Shaban Sadiku" në Klinë	50,000.00		50,000.00
27	Ndërtimi i rrugës "Shaban Polluzha" në Dersnik	50,000.00	30,000.00	20,000.00
28	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Klinë, rrugën Haxhi Zeka, etj	20,000.00		20,000.00
29	Ndërtimi i Urës mbi Lumin Drini i Bardhë në Volljakë	30,000.00		30,000.00
30	Ndërtimi i nxemjes qendrore për Qytetin e Klinës	20,000.00		20,000.00
31	Ndërtimi i Nënkalimit në Lagjen e Dukagjinit - Klinë	10,000.00		10,000.00
	Urbanizmi	3,647,894.00	2,463,000.00	1,184,894.00
32	Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve) në Këpuz, Shtupel, Zllakuqan, Gremnik, Volljak etj	60,000.00	40,000.00	20,000.00
33	Ndërtimi i ujësjellësit në Drenovcë - Poterqi i Poshtëm - Dugujevë - Zajmë - Pataqan - Leskoc - Ranoc etj.	70,000.00	50,000.00	20,000.00
34	Zgjerimi i rrjetit të ndriqimit publik në Dollc-Dresnik, Jashanicë, Drenovc, Shtupel, Kline, Leskoc, Gremnik, Qupeve e ilet, Sipeve, Resnik, Gj. Madhe, Dush etj	100,000.00	70,000.00	30,000.00

35	Rindertimi i infrastruktures mbitokesore me asfalt ne Jashanice,Shtupel,Zllakuqan,Kline-Videje etj	350,000.00	250,000.00	100,000.00
36	Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujrave të zeza në Ranoc, Radulloc, Shtupel, Shtaricë etj	70,000.00	-	70,000.00
37	Ndërtimi i rrethojave të vorrezave në Gj.Madh, Volljak, Sferkë, Jashanicë, Siqevë, Gremnik, Zajm, K.e Vogël, Shtupel, Grabanicë etj	90,000.00	60,000.00	30,000.00
	Infrastruktura rrugore	740,000.00	470,000.00	270,000.00
38	Furnizimi me tabela të mençura për shkollat në Çabiq, Ujmirë, "Ismet Rraci", "Motrat Qiriazit", "Fehmi Agani", "Luigj Gurakuqi", etj	20,000.00	20,000.00	-
39	Ndërtimi i nxemjeve qendrore me pompa termike dhe nxemje me kaldaja me pelet ne shkolla në Gjinnazin Luigj Gurakuqi, Gremnik, Këpuz, Zllakuqan, Gjurgjevik I Madh, Budisalc, Ujmirë, Dren	100,000.00	80,000.00	20,000.00
40	Ndriqimi i hapësirave të jashtme në shkollën Ismet Rraci, Motrat Qiriazit, Gjinnazin Luigj Gurakuqi, Zllakuqan, Çerdhja e fëmijëve etj	-	-	-
41	Ndërtimi i fushave sportive dhe parkingjeve në shkolla në Grabanicë, Siqevë, Zllakuqan, Leskoc, Sferkë etj	70,000.00	50,000.00	20,000.00
	Arsimi	190,000.00	150,000.00	40,000.00
42	Furnizim me paisje mejsore per diagnostike per QKMF-Klinë	50,000.00	30,000.00	20,000.00
43	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve shëndetësore: QKMF-së, AMF-së në Drenoc, Ujmirë, Zllakuqan dhe Gllarevë, etj.	10,000.00	-	10,000.00
	Shendetësia	60,000.00	30,000.00	30,000.00
44	Ndërtimi i shtëpise se pleqeve ne Kline	-	-	-
	Sherbimet Rezidenciale	-	-	-
45	Ndërtimi dhe rindërtimi i objektit komunal ne Kline	20,000.00	-	20,000.00
46	Blerja e veturave zyrtare për nevoja të Administrates Komunale	35,000.00	-	35,000.00
	Administrata	55,000.00	-	55,000.00
47	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve sportive dhe të kulturës në Klinë	25,000.00	25,000.00	-
	Kultura	25,000.00	25,000.00	-
48	Furnizim me pajisje- aparat për matje gjeodezike	-	-	-
	Gjeodezia	-	-	-
49	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në Rudicë-Stupë-Videjë- Zajm,Potërq-Dollovë, Volljakë-Këpuz etj	110,000.00	80,000.00	30,000.00
	Bujqesia	110,000.00	80,000.00	30,000.00
	Totali :	4,827,894.00	3,218,000.00	1,609,894.00

GRUPI PUNUES

Hapi i dytë më radhë për planifikim të hershëm buxhetor, sipas UA (MAPL) Nr.04/2023, neni 31, Dëgjimet buxhetore, pika 3. i cili parasheh që në procesin e planifikimit buxhetor kryetari i komunës themelon një grup punues i cili është ekipi përgjegjës për hartimin e projekt propozimit dhe përgatitjen si dhe realizimin e dëgjimeve buxhetore. Grupi punues udhëhiqet nga drejtoria përkatëse e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit Ekonomik. Organi propozues siguron zbatimin e standardeve minimale të procesit të konsultimit, andaj edhe kryetari i Komunës së Klinës, ka themeluar grupin punues si hapin tjetër vijues të këtij procesi, më datën 13 gusht 2026, më numër protokolli 01 Nr. 112-25805/2026, të udhëhequr nga drejtori e Financave, në këtë përbërje;

1. Melihate Behramaj, Zyrtarja Kryesore Financiare,
2. Faruk Smajli, Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik,
3. Enver Berisha, Drejtoria e Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit,
4. Samije Gjergjaj, Zyrtare për Informim Publik,
5. Nikson Daka, drejtor i Kadastrit dhe Gjeodezisë,
6. Egzon Sejdiu, Udhëheqës i sektorit të Financave,
7. Viktor Kuqi, Asistent administrative i kryetarit,
8. Arbëresha Tanushi, Zyrtare e lart për Buxhet dhe Financa, si dhe
9. Njomëza Jaha, Analiste e lart e Buxhetit.

Neni 30, pika 4, i UA (MAPL) Nr.04/2023, ky grup është i obliguar të planifikojnë kalendarin e dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e komunës 2027-2029 dhe të organizojnë dëgjime buxhetore të përcaktuar sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave publike dhe përgjegjësi.

Lidhur me përfshirjen e palëve të interesuara (çdo person fizik dhe juridik, organizatë e shoqërisë civile, grupe të ndryshme të interesit, si dhe subjekte të tjera që ndikohen apo janë të interesuara të ndikojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi në procesin e vendimmarrjes), në grupet punuese përgjegjëse për hartimin e projekt propozimeve, grupi punues ka angazhuar si trupa ndihmëse edhe;

1. Qendrën e Angazhimit në Komunitet (QAK), koordinatoren, znj. Vitore Zefi, (Qendra e Angazhimit në Komunitet (QAK) është një strukturë e krijuar për të nxitur dhe forcuar pjesëmarrjen qytetare dhe bashkëpunimin midis institucioneve publike dhe komunitetit lokal. Këto qendra zakonisht funksionojnë si hapësira fizike ose platforma ndërveprimi, ku qytetarët mund të japin kontributin e tyre në proceset vendimmarrëse, veçanërisht në fusha si buxhetimi, planifikimi i politikave lokale dhe mbështetja për grupet vulnerabël.)

1. Kryetarët e Këshillave Lokal.
2. Përfaqësuesin nga Zyra për Kthim dhe Komunitete, z. Halil Kerellaj,
3. Zyrtarin për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut si dhe Koordinatorin për Përformancë Komunale, z. Drilon Morina,
4. Komitetin për Politikë dhe Financa, anëtarin/përfaqësuesin Tunë Dedaj,
5. Zyrtaren për Barazi Gjinore, znj. Vitore Shala.

Grupi punues ka qenë përgjegjës për hartimin e Draft Planit të Buxhetit 2027-2029, marrjen e propozimeve dhe komenteve nga dëgjimet buxhetore dhe vendosjen lidhur më pranimin apo jo të tyre si dhe hartimin e raportit të shqyrtimit publik, si dhe obligimet tjera që dalin nga Udhëzimi Administrativ të MAPL-ës nr. 04/2023.

Linku i publikimit të vendimit në web faqen zyrtare; <https://kline.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/08/Draft-Plani-i-Buxhetit-Komunal-te-Klines-per-vitin-2027-2029-1.docx>

ECURIA E DËGJIMEVE BUXHETORE PËR PLANIN E BUXHETIT 2027 - 2029

Pas marrjes së vendimit dhe konsolidimin e grupit punues, bazuar në Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Komuna e Klinës ka bërë një planifikim të hershëm të procesit të konsultimeve publike, si dhe procesin buxhetor më dëgjimeve buxhetore, siç e përcakton edhe neni 20, i këtij udhëzimi.

Zyrtari përgjegjës për konsultim publik koordinim me iniciuesit ka hartuar Planin e Organizimit të Dëgjimeve Buxhetore për Draft Planin e Buxhetit Komunal 2027-2029, i cili merr për bazë afatet kohore, kostot financiare, resurset njerëzore, identifikimin e palëve të përfshira në procesin e konsultimit publik, si dhe format dhe teknikat e konsultimit publik.

Komuna mbetet e përkushtuar edhe në këto dëgjime buxhetore për të siguruar informim të rregullt, të saktë dhe në kohë për qytetarët lidhur me proceset e planifikimit dhe hartimit të dokumenteve buxhetore komunale. Përmes publikimit të njoftimeve, lajmeve, raporteve dhe fotografive nga dëgjimet buxhetore, synohet që qytetarët të kenë qasje të plotë në informacionet relevante, të njihen me propozimet dhe prioritetet e komunitetit, si dhe të përcjellin ecurinë e procesit vendimmarrës.

Publikimi i këtyre materialeve në kanalet zyrtare të Komunës jo vetëm që rrit transparencën institucionale, por gjithashtu forcon pjesëmarrjen qytetare dhe besimin e publikut në institucionet lokale. Çdo dëgjim buxhetor u pasqyrua përmes përmbledhjeve informative dhe dokumentimit fotografik, duke ofruar një pasqyrë të qartë të diskutimeve dhe kontributeve.

Njoftimet dhe lajmet në rrjetin social facebook; <https://kline.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/05/NJOFTIM-PER-DEGJIME-BUXHETORE-Shqip.pdf>

Njoftimi në Web faqen zyrtare;

<https://kline.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/08/Njoftimi-Gj-Shqipe-1.pdf>

<https://kline.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/08/Draf-buxheti-2026-27-PDF.pdf>

Publikimi i procesverbaleve nga 11 takimet të dëgjimeve buxhetore për hartimin e Draft Planin e Buxhetit komunale 2027-2029:

<https://kline.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/09/PROCESVERBAL-TAKIMI-1-pdf.pdf>

<https://kline.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/09/PROCESVERBAL-TAKIMI-2-pdf.pdf>

<https://kline.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/09/PROCESVERBAL-TAKIMI-3-pdf.pdf>

<https://kline.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/09/PROCESVERBAL-TAKIMI-4-pdf.pdf>

<https://kline.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/09/PROCESVERBAL-TAKIMI-5-pdf.pdf>

<https://kline.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/09/PROCESVERBAL-TAKIMI-6-pdf.pdf>

<https://kline.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/09/PROCESVERBAL-TAKIMI-7-pdf.pdf>

<https://kline.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/09/PROCESVERBAL-TAKIMI-8-pdf.pdf>

<https://kline.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/09/PROCESVERBAL-TAKIMI-9-pdf.pdf>

<https://kline.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/09/PROCESVERBAL-TAKIMI-10-pdf.pdf>

<https://kline.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/09/PROCESVERBAL-TAKIMI-11-pdf.pdf>

Sfidë: Një ndër sfidat kryesore me të cilat përballlet Komuna e Klinës është përfshirja e ulët e grave në dëgjimet buxhetore. Kjo mospjesëmarrje jo vetëm që cenon përfaqësimin e barabartë gjinor, por ndikon edhe në hartimin e buxheteve që nuk pasqyrojnë në mënyrë të drejtë nevojat dhe prioritetet e grave në komunitet.

Para datës së takimeve, grupi punues ka njoftuar të interesuarit si kryetarët e bashkësive lokale, media dhe të interesuarit tjerë, se përveç pjesëmarrjes dëgjime, kërkesat dhe sugjerime mund të dëgohen edhe në mënyrë elektronike te zyrtarët:

1. Egzon Sejdiu, email: egzon.sejdiu@rks-gov.net;
2. Melihate Behramaj, email: Melihate.behramaj@rks-gov.net.

Gjithashtu dhe mundësinë e dorëzimit të propozimeve lidhur me këto akte me shkrim në Zyrën e Kryetarit të Komunës, kati II dhe Zyrën e Drejtorisë së Financave, kati I, zyra e dytë, ana e djathtë. Propozimet dhe sugjerimet e të gjithë interesuarve janë mirëpritur **nga data 18.08.2026**, gjatë mbajtjes së dëgjimeve dhe **deri me datën 07.09.2026**.

TABELA E DETAJUAR E METODOLOGJISË SË DËGJIMEVE

Metodat e dëgjimeve	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Ndarja sipas gjinisë	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime
TAKIMI I - Salla e Konferencave, në Komunën e Klinës, me Kryetarët e Këshillave të Fshatrave.	Datë; 27.08.2026, Ora 10:00	18 Pjesëmarrës.	18 Burra, 0 Gra.	2 kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 1 Pranohen, 1 Refuzohet,
TAKIMI II - SHFMU “Isa Boletini”, në fshatin Drenoc më banorët,fshatrave,Poterç i Epërm,Poterç i Poshtëm, dhe Dugajevë.	Datë; 28.08.2026, Ora 17:00	14 Pjesëmarrës.	14 Burra, 0 Gra.	5 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 4 Pranohen, 1 Refuzohen.
TAKIMI III- Dëgjim Buxhetor në SHFMU “Azem Bejta”, në fshatin Grabanicë, më banorët e fshatrave Grabanicë, Dollovë, Bokshiq, Këpuz dhe Qeskovë.	Datë; 28.08.2026, Ora 18:00	11 Pjesëmarrës.	11 Burra, 0 Gra.	8 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 5 Pranohen, 2 Refuzohen. 1 Adresohet
TAKIMI IV -Dëgjim Buxhetor në SHFMU “Motrat Qiriazhi”, në fshatin Zajm, më banorët e fshatrave Zajm,Jagod Gremnik, Deiq, Dollc dhe Dresnik.	Datë; 31.08.2026, Ora 17:00	20 Pjesëmarrës.	20 Burra, 0 Gra.	5 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 5 Pranohen, 0 Refuzohet.

TAKIMI V - Dëgjim Buxhetor në SHFMU “Avni Zhabota”, në fshatin Shtupel, më banorët e fshatrave Shtupel, Kërrnicë, Binxhë, Grabc, (komunitetin joshumicë).	Datë; 31.08.2026, Ora 18:00	21 Pjesëmarrës.	20 Burra, 1 Grua.	4 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 4 Pranohen, 0 Refuzohen,
TAKIMI VI - SHFMU “Ali Krasniqi”, në fshatin Ujmirë, me banorët e fshatrave, Ujmirë Jashanicë, Pogradjë, Dush i Vogël, Shtaric, Dush, Resnik, Siqevë Jelloc, Gjurgjevik i Madh, Qabiq Doberdol.	Datë; 01.09.2026, Ora 17:00	9 Pjesëmarrës.	9 Burra, 0 Grua.	7 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 6 Pranohen, 1 Adresohen.
TAKIMI VII – SHFMU “Emin Duraku”, në fshatin Sferkë, me banorët e fshatrave, Sferkë, Gllarevë, Caravik, Volljakë, Qupevë Zabergjë, Përçevë, Rixhevë, Stapanic	Datë; 01.09.2026, Ora 18:00	10 Pjesëmarrës.	10 Burra, 0 Grua.	3 kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 2 Pranohen, 1 Refuzohen,
TAKIMI VIII - SHFMU “Nënë Tereza”, në fshatin, Budisalc më banorët e fshatrave, Budisalc, Zllakuqan, Berkovë, Ranoc, Leskoc, Nagllavë, Dranashiq, Stupë, Rudicë, Radulloc, Videjë, Krushevë e Madhe, Krushevë e Vogël dhe Rudicë.	Datë; 03.09.2026, Ora 17:00	13 Pjesëmarrës.	13 Burra, 0 Gra.	3 kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 3 Pranohen, 0 Refuzohen.
TAKIMI IX - Dëgjim Buxhetor në Sallen e koferncave Komuna Klinës kati III”, me temë “Prioritetet e grave dhe të rinjve të komunës së Klinës”.	Datë; 03.09.2026, Ora 16:00	5 Pjesëmarrës.	0 Burra, 5 Gra.	3 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara. 2 Pranohen. 1 Adresohet.

TAKIMI X - Salla e Kuvendit Komunal Klinë, takim i përgjithshëm me banorët e Komunës së Klinës, qytetit dhe lagjeve, klinafcit dhe Gjurgjevik i Vogel	Datë; 04.09.2026 Ora 10:00	13 Pjesëmarrës.	12 Burra, 1 Gra.	3 kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 2 Pranohen, 1 Adresohet.
TAKIMI XI - Salla e Kuvendit Komunal Klinë, më Asamblen Komunalë të Femijëve.	Datë: 04.09.2026 Ora 11:30	13 pjesëmarrës	10 Femra, 3 , Meshkuj.	15 kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 5 Pranohen, 10 Adresohen.
Publikimi në ueb-faqe / platforma.	21 ditë	0 pjesëmarrës	0 Gra, 0 Burra.	0 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara nga publikimi në ueb-faqe/platforma.
Kërkesa më email të personat e caktuar.	21 ditë	0 pjesëmarrës	0 Grua, 0 Burrë.	0 kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 0 Pranohen, 0 Refuzohen.
Kërkesa në formë fizike.	21 ditë	0 pjesëmarrës	0 Gra, 0 Burra.	0 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara nga publikimi në ueb-faqe/platforma.

Kërkesa në formë fizike nga OJQ dhe Grupe Specifike.	21 ditë	0 pjesëmarrës	0 Gra, 0 vajza, dhe 0 Burra.	0 kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 0 Pranohen, 0 Refuzohet, Adresohet.
Gjithsej;	21 ditë 18.08.2026- 07.09.2026.	147 pjesëmarrës	17 Gra, Dhe 130 Burra.	58 kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 39 Pranohen, 5 Refuzohen, 14 Adresohen

VLERËSIMI I GRUPIT PUNUES MBI KËRKESAT E QYTETARËVE

Grupi punës ka grumbulluar të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe të njëjtat pasi i ka vendosur në dokumentin punues i ka analizuar dhe komfor standardeve të përcaktuara më lartë ka vendosur për pranimin, pranimet të pjesshëm, refuzimin dhe adresimin e kërkesave. Vendimet e anëtarëve të grupit janë pasqyruar në tabelën /shtojcën nr. 5 bashkë me arsyetimet e grupit.

Shtojca nr. 2 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara:

Personi i kërkesës si dhe Kërkesat, Sugjerimet dhe Komentet.	Statusi i Kërkesës, Sugjerimit dhe Komenteve.	Arsyetimi (komentimi për pranimin, pjesërisht i pranueshëm dhe mospranimin të komenteve është i detyrueshëm).
DËGJIMI BUXHETOR NË SALLËN E KONFERENCAVE, NË KOMUNËN E KLINËS, ME KRYETARËT E KËSHILLAVE TË FSHATRAVE.		
Binak Gashi, Kryetar i Këshillit Lokal në Gremnik;	Refuzohet Pranohet	Përgjigja:

1.Dy deponi te berllogut ne fshatin ton paraqesin rrezik per jeten e qytetarve tone		Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbimet lidhur me kërkesën sipas pikës 1 nuk janë në përgjegjësi komunale dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë nuk mundet të jetë pjesë e projeksioneve të Buxhetit Komunal 2027-2029. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, mund të ekzistojë ndarja e mjeteve buxhetore në vitet në vijim.
2.Kerkesa tjetër është ujin e pijes ne fshatin ton		

DËGJIMI BUXHETOR NË SHFMU “ISA BOLETINI DRENOC” MË BANORËT E FSHATRAVE DRENOC,PJETERQ I EPERM, PJETERQ I POSHTEM,DUGAJEVË

Nuhi Agushi,Drenoc 1.Kërkesa jem per ju është 30 metra muri mbrojtës sepse kemi problem me rrëshitje te dheut ne lagjen tone	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se punimet për këtë kërkesë të parashtruar kanë filluar.
Mark Marku, Drenoc 1.Kërkesa ime është që një rrugë fushore të ndërhyhet me zhavor, pasi kemi problem t'i kultivojmë tokat tona dhe të kemi mundësi të kalojmë nëpër atë rrugë. 2.Kërkesa tjetër do të ishte edhe rreth 100 metra asfalt për rrugën që shkon te varrezat e lagjes sonë edhe ujët e pijes është një problem thelbësor.	Pranohet Refuzohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Buxhetit Komunal 2027-2029. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore Poterq- Dugajevë-Drenoc”, gjithashtu edhe rregullimit i ujësjellësit sipas projektit “Ndërtimi i ujësjellësit në Drenoc - Poterqi i Poshtëm - Dugujevë - Zajmë - Pataqan - Leskoc - Ranoc etj”.
Gjon Cubi, Drenoc Kërkesa ime është që gjatë vërshimeve, lumenjtë që janë afër tokave bujqësore, kur ka reshje të mëdha atmosferike, po na i dëmtojnë të gjitha kulturat bujqësore dhe po na i prishin të mbjellat. Nëse ka mundësi, të mbushen me drenazh ose me	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i shtratit të lumit Klina, (Klinë-Burimi i Jarinës - Pogragjë-Ujmirë),

dhe, në mënyrë që uji të mos kalojë në tokat bujqësore dhe të mos i dëmtojë kulturat tona.		Rregullimi i shtratit të lumit Lumëbardhi i Pejës dhe lumit Drini I Bardhe.”
Dedë Berisha, Dugajevë Përshëndetje të gjithëve. Kërkesa ime për ju është vendosja e rreth 40 metrave gypa për ujë, sepse gjatë vërshimeve uji po më shkakton dëme dhe po më hyn në podrum nëse ka mundësi, të ndërhyhet në këtë pjesë për të parandaluar vërshimet dhe dëmet që po më shkaktohen.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029 sa i përket gypave të mbyllur në fshatin tuaj parashihet t’i bashkëngjitet projektit “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore Poterq- Dugajevë-Drenovc”
DËGJIMI BUXHETOR NË SHFMU “AZEM BEJTA”, NË FSHATIN GRABANICË, MË BANORËT E FSHATRAVE GRABANICË, DOLLOVË, BOKSHIQ, KËPUZ DHE QESKOVË.		
Xhevat Thaqi, Bokshiq Përshëndetje të gjithëve, Kam disa kërkesa: 1.Problemi kryesor në lagjen tonë është furnizimi me energji elektrike (shtyllat), ku kemi pasur dhe vazhdojmë të kemi probleme të shpeshta. Kërkojmë që kjo çështje të trajtohet dhe të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme. 2. Një problem tjetër është emërtimi pasi mungesa e emrave të rrugëve krijon vështirësi për banorët dhe për shërbimet e ndryshme gjithashtu, 3.Disa nga rrugët e lagjes janë të dëmtuara, kërkojmë që të bëhet një vlerësim i gjendjes së tyre dhe të ndërmerren masat e nevojshme për sanimin e pjesëve të dëmtuara 4:Një çështje tjetër thelbësore është uji i pijshëm furnizimi i rregullt dhe cilësor me	Refuzohet Adresohet Pranohet Pranohet	1. Grupi punues ka konstatuar se mirëmbajtja e tensionit të lartë nuk është përgjegjësi e komunës dhe kërkesa nuk mund të përfshihet në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Kjo kërkesë i adresohet Kompanisë Kosovare për Distributim të Energjisë Elektrike – KEDS, pasi komuna e Klinës nuk ka kompetenca për të intervenuar në sistem të tillë dhe KEDS është përgjegjëse për rrjetin e energjisë elektrike. 2. Grupi punues ka konstatuar se për shqyrtimin e kërkesës në fjalë duhet t’i adresohet kërkesa Komisionit përkatës për emërtimin e rrugëve, Komisioni i votuar nga Asambleja Komunale. 3. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe

ujë të pijshëm është një nevojë bazë për çdo familje dhe kërkojmë që edhe kjo problematikë të trajtohet me prioritet.		mbitokësore në Grabanicë-Bokshiq-Dollovë” 4. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i ujësjellësit në Drenovcë - Poterqi i Poshtëm - Dugujevë - Zajmë - Pataqan - Leskoc - Ranoc etj”.
Zenel Mehemetaj, Bokshiq: Kërkesat e mia për fshatin Bokshiq janë: 1.Rregullimi i shtyllave dhe rrjetit elektrik 2.Zgjidhja e problemit me ujin e pijshëm 3.Rregullimi i kanalizimit sanimi i disa rrugëve që kanë pësuar dëmtime	Refuzohet Pranohet Pranohet	1. Grupi punues ka konstatuar se mirëmbajtja e tensionit të lartë nuk është përgjegjësi e komunës dhe kërkesa nuk mund të përfshihet në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Kjo kërkesë i adresohet Kompanisë Kosovare për Distributim të Energjisë Elektrike – KEDS, pasi komuna e Klinës nuk ka kompetenca për të intervenuar në sistem të tillë dhe KEDS është përgjegjëse për rrjetin e energjisë elektrike. 2. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i ujësjellësit në Drenovcë - Poterqi i Poshtëm - Dugujevë - Zajmë - Pataqan - Leskoc - Ranoc etj”. 3. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Grabanicë-Bokshiq-Dollovë”
Shkeqlim Hasanai, Bokshiq Kërkesa ime është që një firmë private, me kamionë të peshave të mëdha, ka dëmtuar një pjesë të rrugës shumë keq. Kisha pasur kërkesë, nëse është e mundur, të ndërhyjë aty, sepse kemi vështirësi në kalimin në atë pjesë të rrugës.	Pranohet	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se punimet për këtë kërkesë të parashtruar kanë filluar.

DËGJIMI BUXHETOR NË SHFMU “MOTRAT QIRIAZI”, NË FSHATIN ZAJM, MË BANORËT E FSHATRAVE ZAJM, GREMNIK, DEIQ, DOLLÇ, JAGOD, DHE DRESNIK.

Blerton Sopaj, Zajm Kërkojmë që në rrugën nga parku në fshatin Zajm të bëhet renovimi i asfaltit, pasi janë krijuar rreth 24 prerje nga ndërhyrjet e banorëve gjithashtu, kërkojmë të shqyrtohet mundësia e largimit të disa pengesave të shtrira të vendosura në rrugë, pasi numri i tyre është i madh dhe vështirësojnë qarkullimin.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Zajmë-Deiq”
Metë Krasniqi, Zajm Kërkesa ime është: 100 metra kanalizim në lagjen Sopaj.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Zajmë-Deiq”
Dalip Gashi, Zajm Kërkesa ime është: jemi katër shtëpi në fshatin Zajm që nuk kemi kanalizim. A ka mundësi të na ndihmoni.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Zajmë-Deiq”
Tun Dedaj (Deiq): Kam dy kërkesa të banorëve: një për fshatin Zajm dhe një për fshatin Deiq. 1.Kërkoj që të shqyrtohet mundësia për ndërtimin e nga një këndi lojërash për fëmijë në të dyja fshatrat. 2.Gjithashtu, kërkoj zgjerimin e një kanali të ujit	Pranohet Pranohet	Përgjigja: - Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projektit “Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve) në Këpuz, Shtupel, Zllakuqan, Gremnik, Volljak etj” - Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i shtratit të lumit Klina, (Klinë-Burimi i Jarinës - Pogragjë-Ujmirë), Rregullimi i shtratit të lumit Lumëbardhi i Pejës dhe lumit Drini I Bardhe.”

DËGJIMI BUXHETOR NË SHFMU “AVNI ZHABOTA”, NË FSHATIN SHTUPEL, MË BANORËT E FSHATRAVE SHTUPEL, KËRRNICË, BINXHË, GRABC, (KOMUNITETIN JOSHUMICË).

Blerim Temaj, Shtupel Kërkesat e mia janë: 1. Të ndërtohet një park në fshatin tonë. 2. Nuk kemi ujë. 3. Të rregullohet ndriçimi publik në disa lagje.	Pranohet Pranohet Pranohet	Përgjigja: 1. Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projektit “Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve) në Këpuz, Shtupel, Zllakuqan, Gremnik, Volljak etj” 2. Grupi punues ka konstatuar se në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, mund të ekzistojë ndarja e mjeteve buxhetore në vitet në vijim. 3. Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projektit “Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në Dollc-Dresnik, Jashanice, Drenovc, Shtupel, Kline, Leskoc, Gremnik, Qupeve e ulet, Siqeve, Resnik, Gj.Madhe, Dush etj
Ismet Imeri, Shtupel Kërkesa ime është për shtrimin me asfalt të një rruge prej 700 metrash	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projektit ”Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në Shtupel-Kërrnicë-Binxhe-Grabc”
DËGJIMI BUXHETOR NË SHFMU “ALI KRANIQI”, NË FSHATIN UJEMIRË, ME BANORËT E FSHATRAVE, UJMIRË, JASHANICË, POGRAGJË, DUSH, DUSH I VOGËL, RESNIK, JELLOC, GJURGJEVIK I MADH, UJMIRË, DOBERDOL, SIQEVË, SHTARIC DHE ÇABIQ.		
Kadri Vishaj, Doberdol Kërkesa ime ka të bëjë me transportin e nxënësve ka filluar procesi mësimor, ndërsa këtë vit transporti për fëmijët ende	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një

munjon a do të ketë transport për nxënësit dhe kur pritët të fillojë?		projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Planit të Buxhetit Komunal 2027-2029.
Tush Berisha, Doberdol Kam disa kërkesa: 1.Vazhdimi i ndriçimit publik aty ku ka mbetur, 2.kanalizimi është i bllokuar në tri pika dhe ka nevojë për intervenim, 3.Ndërtimi i trotuarit, 4.Ndërtimi i një parku të varrezat, në mënyrë që të krijohet një hapësirë e përshtatshme për banorët, 5.Vendosja e tabelave me emrat e fshatrave, pasi disa prej tyre ende nuk kanë tabelë dhe emërtim të qartë.	Pranohet Pranohet Pranohet Adresohet	Përgjigja: 1. Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projektit “Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në Dollc-Dresnik, Jashanice, Drenovc, Shtupel, Kline, Leskoc, Gremnik, Qupeve e ulet, Siqeve, Resnik, Gj.Madhe, Dush etj” 2. Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projektit “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Cerovik-Qabiq-Dobërdol” 3. Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projektit “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Cerovik-Qabiq-Dobërdol” 4. Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projektit “Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve) në Këpuz, Shtupel, Zllakuqan, Gremnik, Volljak etj” 5. Grupi punues ka konstatuar se për shqyrtimin e kërkesës në fjalë duhet t’i adresohet kërkesë e veçant pran Drejtorisë përkatëse.
Alfred Buzhala, Qabiq Kërkesa ime për Komunën është ndërtimi i 175 metrave kanalizim, pasi kemi ndërtuar pesë shtëpi të reja dhe kemi nevojë për kyçe në rrjetin e kanalizimit.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka konstatuar se në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, mund të ekzistojë ndarja e mjeteve buxhetore në vitet në vijim.

DËGJIMI BUXHETOR NË SHFMU “EMIN DURAKU”, NË FSHATIN SFERKË, ME BANORËT E FSHATRAVE: SFERKË, GLLAREVË, CARAVIK, RIXHEVË, STAPANIC, VOLLJAKË, ZABERGJË, PËRÇEVË, QUPEVË

Sadri Berisha, Dush i Sferkës 1.Kërkesa ime është që të rregullohet ndriçimi publik 2. Problemi i dy deponive të mbeturinave në fshatin tonë.	Pranohet Refuzohet	Përgjigja: 1. Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projektit “Zgjerimi i rrjetit të ndriqimit publik në Dollc-Dresnik, Jashanice, Drenovc, Shtupel, Kline, Leskoc, Gremnik, Qupeve e ulet, Siqeve, Resnik, Gj.Madhe, Dush etj” 2. Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbimet lidhur me kërkesën sipas pikës 1 nuk janë në përgjegjësi komunale dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë nuk mundet të jetë pjesë e projeksioneve të Buxhetit Komunal 2027-2029.
Emin Balaj, Gllarevë Një nga kërkesat kryesore për fshatin tonë, Gllarevën, është sigurimi i ujit të pijshëm	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka konstatuar se në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, mund të ekzistojë ndarja e mjeteve buxhetore në vitet në vijim.
DËGJIMI BUXHETOR NË SHFMU “NËNË TEREZA”, NË FSHATIN BUDISALC, MË BANORËT E FSHATRAVE BUDISALC, ZLLAKUQAN, BERKOVË, RANOC, RADULLOC, LESKOC, NAGLLAVË, DRANASHIQ, STUPË, RUDICË, VIDEJË, KRUSHEVË E MADHE DHE KRUSHEVË E VOGËL		
Vilson Zefi, Ranoc Pershendetje te gjithve kam disa kerkesa per fshatin Ranoc: 1.Ndërtimi i ujësjellësit 2.Ndërtimi i trotuareve me ndriçim public, 3.Asfaltimi i disa rrugicave të vogla.	Pranohet Pranohet Pranohet	Përgjigja: 1. Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projektit “Ndërtimi i ujësjellësit në Drenovcë - Poterqi i Poshtëm - Dugujevë - Zajmë - Pataqan - Leskoc - Ranoc etj.” 2. Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në

		përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projektit “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukture nëntokësore Zllakuqan-Pataqan-Berkove, Krushevë e Vogël (trotuari Klinë-Zllakuqan)” 3. Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projektit “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukture nëntokësore Zllakuqan-Pataqan-Berkove, Krushevë e Vogël (trotuari Klinë-Zllakuqan)”
--	--	---

DËGJIMI BUXHETOR NË SALLËN E KONFERNCAVE KOMUNA KLINË KATI III”, ME TEMË “PRIORITETET E GRAVE DHE TË RINJVE TË KOMUNËS SË KLINËS”.

Majlinda Morina, Klinë Kërkesa ime është që kam plan të hap një biznes privat dhe dëshiroj të di nëse ka mundësi që Komuna të më ndihmojë në blerjen e pajisjeve të nevojshme	Adresohet	Përgjigja: 1. Grupi punues ka konstatuar se për shqyrtimin e kërkesës në fjalë duhet t’i adresohet Thirrjeve Publike.
Bete Gojani, Klinë Kërkesa ime është 1.Rrugicë e shkurtër në fshatin Radulloc të shtrohet me asfalt. 2.Ndërtohet një trotuar me ndriçim publik, së bashku me një shëtitore në fshatin Radulloc.	Pranohet Pranohet	Përgjigja: 1. Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projektit “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukture nëntokësore Zllakuqan-Pataqan-Berkove, Krushevë e Vogël (trotuari Klinë-Zllakuqan)” 2. Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projektit “Zgjerimi i rrjetit të ndriqimit publik në Dollc-Dresnik, Jashanice, Drenovc, Shtupel, Kline, Leskoc, Gremnik, Qupeve e ulet, Siqeve, Resnik, Gj.Madhe, Dush etj”

DËGJIMI BUXHETOR NË SALLA E KUVENDIT KOMUNAL KLINË, TAKIM I PËRGJITHSHËM ME BANORËT E KOMUNËS SË KLINËS, QYTETIT DHE LAGJEVE, KLINAFÇIT DHE GJURGJEVIK I VOGËL.

Tunë Dedaj, Deiq Përshëndetje të gjithëve. I nderuar Kryetar, të nderuar të pranishëm, Kërkesa ime është përkatësisht për fshatin Deiq, për vazhdimin e trotuarit prej kishës, aty ku ka mbetur, si dhe për asfaltimin e një rruge në fshatin Videjë.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projektit “Ndertimi i infrastruktures mbitoksore (Trotuare) dhe infrastruktures nentokesore ne Zajm-Deiq”
Arif Berisha, Gjurgjevik I Madhe Kërkesa ime ka të bëjë me rrugën kryesore të fshatit, e cila lidhet me rrugën nacionale në Dollc. Kjo rrugë është dëmtuar si pasojë e qarkullimit të kamionëve me pesha të rënda dhe ka nevojë për intervenim dhe sanim.	Adresohet	Përgjigja: Grupi punues ka konstatuar se për shqyrtimin e kërkesës në fjalë Pasi që rrugën e kanë dëmtuar kamionat duhet t’i adresohet Linjës përkatëse.
Ragip Kryeziu, Klinë Kërkesa ime ka të bëjë me rrugën që fillon nga zona e Interex-it dhe vazhdon deri në dalje të Klinës, tek ura do të doja të dija pse kjo pjesë e rrugës ende nuk është asfaltuar dhe kur parashihet të realizohet asfaltimi i saj.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se punimet për këtë kërkesë të parashtruar kanë filluar.

DËGJIMI BUXHETOR NË SALLA E KUVENDIT KOMUNAL KLINË, TAKIM MË ASMBLENË KOMUNALË TË FËMIJËVE

Erza Agushi Kryetare e Asamblesë Komunale të Fëmijëve Kërkesat: 1.Ndërtimi dhe mirëmbajtja e trotuareve pranë shkollave, me qëllim rritjen e sigurisë së nxënësve. 2.Pajisja e shkollave me kabinete të Teknologjisë së Informacionit (TIK) dhe pajisje moderne teknologjike. 3.Furnizimi i shkollave me banka dhe karrige të reja dhe të përshtatshme për nxënësit.	Adresohen Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se të gjitha kërkesat që vijnë nga Asambleja Komunale e Fëmijëve janë adresuar Drejtorisë përkatëse, DKA-së, po ashtu disa nga këto kërkesa janë të Planifikuara në peojktet e vitit 2027-2029.
--	---	---

4.Përmirësimi i kushteve higjienike dhe sanitare në shkolla. 5.Krijimi i hapësirave të sigurta dhe të përshtatshme për aktivitete kulturore, artistike dhe rekreative të fëmijëve. 6.Sigurimi i mjeteve dhe materialeve të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të nxënësve.		
Taulant Gashi Përfaqësues i Këshillit të Nxënësve në Shkollën “Ismet Rraci” Kërkesat: 1.Pajisja e klasave me tabela dixhitale dhe mjete të tjera moderne të mësimdhënies. 2.Përmirësimi dhe rinovimi i infrastrukturës dhe hapësirave të brendshme dhe të jashtme të shkollës. 3.Furnizimi me banka dhe karrige të reja dhe të përshtatshme për nxënësit. 4.Pasurimi i bibliotekës së shkollës me libra të rinj dhe literaturë të përshtatshme për grupmoshat e nxënësve. 5.Ndërtimi dhe përmirësimi i fushave sportive dhe palestrave të shkollës. 6.Krijimi i hapësirave të gjelbra dhe këndeve rekreative për nxënësit. 7.Sigurimi i pajisjeve sportive dhe mjeteve të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve fizike. Organizimi i më shumë aktiviteteve kulturore, sportive dhe edukative për nxënësit. 8.Përmirësimi i qasjes në internet dhe pajisjeve teknologjike për mësim më bashkëkohor.	Adresohet Pranohet	Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se të gjitha kërkesat që vijnë nga Asambleja Komunale e Fëmijëve janë adresuar Drejtorisë përkatëse, DKA-së, po ashtu disa nga këto kërkesa janë të Planifikuara në peojktet e vitit 2027-2029.

9.Krijimi i një ambienti shkollor më të sigurt, gjithëpërfshirës dhe miqësor për të gjithë nxënësit.		
--	--	--

Shtojca nr. 3 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara në web faqe dhe platforma online:

Personi i kërkesës si dhe Kërkesat, Sugjerimet dhe Komentet.	Statusi i Kërkesës, Sugjerimit dhe Komenteve.	Arsyetimi (komentimi për pranimin, pjesërisht i pranueshëm dhe mospranimin të komenteve është i detyrueshëm).
PUBLIKIMI NË UEB-FAQE / PLATFORMA.		
0 pjesëmarrës.	0 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara.	Grupi punues nuk ka pranuar asnjë koment/sugjerim apo kërkesë nga publikimi në ueb-faqe/platforma, pasi platforma e-konsultimet ka qenë jashtë funksionit.

Shtojca nr. 4 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e pranuar më email:

Personi i kërkesës si dhe Kërkesat, Sugjerimet dhe Komentet.	Statusi i Kërkesës, Sugjerimit dhe Komenteve.	Arsyetimi (komentimi për pranimin, pjesërisht i pranueshëm dhe mospranimin të komenteve është i detyrueshëm).
KËRKESA MË EMAIL TË PERSONAT E CAKTUAR.		
	0 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara.	

Shtojca nr. 5 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e pranuar në formë fizike:

Personi i kërkesës si dhe Kërkesat, Sugjerimet dhe Komentet.	Statusi i Kërkesës, Sugjerimit dhe Komenteve.	Arsyetimi (komentimi për pranimin, pjesërisht i pranueshëm dhe mospranimin të komenteve është i detyrueshëm).
KËRKESA NË FORMË FIZIKE.		

	0 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara.	
--	--	--

Shtojca nr. 6 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e pranuar në formë fizike nga OJQ dhe grupe tjera specifike:


Personi i kërkesës si dhe Kërkesat, Sugjerimet dhe Komentet.	Statusi i Kërkesës, Sugjerimit dhe Komenteve.	Arsyetimi (komentimi për pranimin, pjesërisht i pranueshëm dhe mospranimin të komenteve është i detyrueshëm).
KËRKESA NË FORMË FIZIKE NGA OJQ DHE GRUPE SPECIFIKE.		
	0 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara.	Përgjigja: Grupi punues ka vlerësuar se kërkesa është në kompetencë të komunës.

Komuna e Klinës ka vazhduar të demonstrojë përkushtim të lartë në garantimin e një procesi buxhetor të hapur, transparent, gjithëpërfshirës dhe të qasshëm për të gjithë qytetarët. Në kuadër të hartimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), organizimi i dëgjimeve publike ka shërbyer si një mekanizëm i rëndësishëm për përfshirjen aktive të qytetarëve dhe grupeve të interesit në procesin e planifikimit dhe priorizimit të financave publike komunale.

Duke njohur rëndësinë e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje, Komuna ka synuar të sigurojë transparencë të plotë gjatë të gjitha fazave të procesit buxhetor. Në këtë drejtim, dokumentacioni përkatës është publikuar me kohë, ndërsa informacioni është komunikuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për qytetarët, me qëllim të lehtësimit të pjesëmarrjes së tyre të informuar. Për të rritur qasjen dhe përfshirjen e sa më shumë qytetarëve, Komuna ka aplikuar një qasje fleksibile në organizimin e dëgjimeve buxhetore. Takimet janë zhvilluar në forma të ndryshme, duke kombinuar pjesëmarrjen fizike dhe atë virtuale, si dhe duke u organizuar në lokacione të ndryshme brenda territorit të komunës. Kjo ka mundësuar që qytetarët nga komunitete dhe zona të ndryshme të kenë mundësi të barabarta për të paraqitur nevojat, propozimet dhe rekomandimet e tyre lidhur me planifikimin buxhetor. Përmes këtij procesi, Komuna e Klinës ka forcuar dialogun me qytetarët dhe ka kontribuar në ndërtimin e një qeverisjeje më transparente, më llogaridhënëse dhe më të orientuar drejt nevojave reale të komunitetit.

Zyrtari përgjegjës për konsultim publik

Egzon Sejdiu


Klinë, 22.09.2026
